




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ee.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seanca e **IV (katërt)** të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 6.4.2012 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

- 2.2 Propozim-vendimi për shpalljen e Partneritetit publiko-privat: Lokacioni te "Magjistranja"
- 2.3 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike për ndërtimin objektit të Agjencionit të Inteligjencës së Kosovës në Gjilan,
- 2.4 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës përbrenda Kompleksit të shkollave të mesme,
- 2.5 Studimi i arsyeshmëris së PPP -Rregullimi i infrastrukturës të Kompleksit të shkollave të mesme të Gjilanit
- 2.6 Shqyrtimi i Draft kontratës për PPP të KRM "Higjiena"
- 2.7. Vendimi për miratimin e Statutit të Ndërmarrjes "ECOHIGJIENA"
- 2.8 . Propozim vendimi për largimin e mbetjeve nga ish Lapidari në fshatin Zhegër,
- 2.9. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P- 70403013-00635-7, me sipërfaqe prej 370 m², ZK-Gjilan.
- 2.10. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të pronarëve: Zyrafete Korqa-Xhevat Selimi dhe KK-Gjilan,
- 2.11. Propozim vendimi për ndryshimin Rregullores për taksat, ngarkesa dhe gjoha komunale,
- 2.12. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për student,
- 2.13. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale të arsimtarëve të cilat kanë kandiduar në zgjedhjet lokale të vitit 2007.
- 2.14. Vendimi për autorizimin e Komisionit për akte normative për ndryshimin Dhe plotësimin e Rregullores për punën e Kuvendit

3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Seancës

- Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së tretë (pjesa e dytë) ishin prezent :

Anëtarët e Kuvendit,

Kryetari i Komunës,

Drejtorët e drejtorive,

Përfaqësuesit e OSB-së

Njësia për Mbrotjtjen e te Drejtave të Njeriut

Mediet

Seancën e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSB-së dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

Në vijim të fjalës së tij kryesuesi theksoi se këtë seancë e fillojmë sipas rendit të punës të cilin e kemi aprovuar në seancën e kaluar, sepse ky është vazhdim i seancës së tretë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në këtë seancë janë të pranishëm 36 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë 5: Elisah Ymeri, Ibish Ibishi, Sadanda Bllaca, Tefik Ibrahimimi dhe (Abdyl Aliu i cili erdhi në seancë, por me vonesë).

Pasi sekretari konstatoi prezencën kryesuesi theksoi se ata të cilët vijnë me vonesë mos t'i epet lista për t' u nënshkruar, sepse nuk i vlen nënshkrimi.

Ata të cilët vijnë në gjysmë të seancës nuk mund të marrin mëditje, kjo të jetë e qartë që nga seanca e sotme.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.2. Propozim-vendimi për shpalljen e Partneritetit publiko-privat Lokacioni te “Magjistranja

Bahrie Mahmuti- sa i përket kësaj pike për hyrje në PPP, tek lokacioni “Magjistranja”, Drejtoria e Urbanizmit duke i parë zhvillimit në këtë zonë kemi propozuar një projekt i cili është në kuadër të planit rregulluese “Kodra e Thatë” i cili është miratuar në vitin 2010. Në këtë bllok janë të përshkruara destinimet e të cilin destinim e keni në materialin e juaj. Në këtë bllok është propozuar zgjidhje e cila në destinim ka objekte banesore afariste, mandej institucione parashkollor, çerdhe dhe kopshte si dhe hapësirat e tjera përcjellëse si parkingjet nëntokësore, terrenet sportive dhe hapësirat gjelbëruese.

Në vijim të fjalës së saj drejtorja dhe sqarime edhe më detale në bazë të planit të cilin e ka hartuar drejtoria e cila e sqaroi me anë të kino-projektorit, por të cilin anëtarët e Kuvendit e kanë në material.

Nëse ka paqartësi, mund të kërkonin sqarime, kurse ne do të mundohemi të japim përgjigje?

Sabedin Kadriu- në disa raste për propozim rregullim të planeve urbanistike, janë përmendur disa gishta të gjelbërimit të cilat i kemi parë në sllajde dhe unë mendoj se konformë atyre propozimeve, kjo fare nuk ka të bëjë me gjelbërim!

Për këtë arsye, unë si qytetar i Gjilanit dëshiroj që Komuna të mendojë dhe planifikojë më tepër hapësira gjelbëruese e të cilat këtu nuk shihen, prandaj kjo është një arsyeje pse unë jam kundër këtij propozimi.

Kjo është sikur kur ishte LDK në pushtet e cila e pat bërë një beton para Komunës i cila ka mbet edhe sot si shëmtim, por edhe kur ka të reshura aty bëhet edhe moçalishte!

Po të kishte qenë ajo e tërë gjelbërim edhe qyteti do të kishte pasur tjetër pamje dhe gjelbërimi do të kishte kushtuar më lirë. Mirëpo kjo është bërë, sepse mundësitë për keqpërdorim kanë qenë më të mëdha me beton se sa me gjelbërim. Edhe këtu po përsëritet e njëjta gjë, sepse unë mendoj se Komuna e Gjilanit ka nevojë për gjelbërime dhe zona të gjelbra që janë përmendur në atë kohë dhe pikërisht në këtë zonë. Unë mendoj se edhe kjo pjesë edhe ajo te Stacioni i Autobusëve është koha për t' u ndërtuar një park, në të cilin park qytetari do ta ndiente një kënaqësi.

Arsyeje e dytë pse unë jam kundër këtij projekti është se aty para disa vite ka pasur filluar një objekt i cili ka pasur leje ndërtimi, mirëpo kryetari i Komunës ia ka marrë lejen atij objekti me pretekst se qytetarëve po i pengohet hapësira, por edhe me një pretekst shumë banal dhe të vrazhdët se gjëja qytetarët nuk dëshirojnë njerëz të hendikepuar afër banesave të tyre e të cilët e kemi shpallur edhe monstrum se gjëja qytetarët nuk i duan ata njerëz!

Tjetër është se këtu unë nuk shoh interes të qytetarëve përveç interesit të njerëzve të caktuar për të përfutur shuma të mëdha të parave, sepse banesa në mes të qytetit është më e shtrenjtë se ajo në periferi të qytetit.

Gjithashtu në një objekt në të cilin nuk ka interes qytetari, unë do të jem kundër atij projekti, sepse PPP nuk është i paraparë për të ngrit ndërtesa, në të cilat ndërtesa fitojnë individët e aspak qytetarët! Deri më tash nuk jam bindur se qytetari po fiton në këtë projekt, por po fitojnë individët, prandaj jam kundër dhe i ftoj edhe kolegët e mi që të jenë kundër këtij propozim-vendimi për këto arsye që i thash.

Komuna e Gjilanit ka nevojë për gjelbërim dhe nuk ka nevojë Gjilanit për beton, sepse ka mjaft beton dhe qytetarët nuk fitojnë asgjë me këtë projekt.

Izmi Zeka- në demokraci mendimi ndryshe është kolorit. Duhet kuptuar se dhe kur je parti në pushtet edhe kur ke mendim ndryshe, është mrekulli. Mirëpo duhet kuptuar se në fund votat vendosin. Është e drejtë e dikujt të jetë kundër, por jo të thuhet se dikush ka gisht këtu dhe dikush po merr para! Kjo është paragjykim dhe për këtë nuk ka fakte! Nëse ka fakte janë organet e hetuesisë dhe ato mund t' i paraqitni.

Sabedin Kadriu- unë nuk thash që ka gisht dikush, por i përmenda disa gishta në projekte, gishta të gjelbërimit. Ekspertët e kanë thënë “gishta të gjelbërimit”. Unë nuk e thash që ka gisht dikush, por mundësia për të keqpërdor më lehtë është me beton, se sa në bari. Një kg bari kushton 20 euro, kurse betoni kushton shumë më shtrenjtë. Unë arsyet i thash sepse unë si qytetar i Gjilanit dua të kem gjelbërim dhe jo beton! Unë kam qenë kundër edhe kur LDK-ja e ka bërë atë beton në qendër të qytetit, sepse me 2 mijë euro ka pasur mundësi aty të jetë gjelbërim, por janë investuar shumë e madhe e parave dhe ajo nuk duhet asgjë, ajo është moçalishtë!

Unë nuk e akuzova askënd, aty para disa viteve ka qenë një projekt, aty iu ka marrë leja me arsyetim se banorëve po iu ngushtohet hapësira. Unë thash se i kemi shpall monstrum ata njerëz, sepse kanë bërë ankesë se nuk i duan njerëzit e hendikepuar afër veti. Kjo për mua ka qenë shumë banale në atë kohë.

E treta pyeta se çka fiton qytetari, këtë dua ta di? PPP për mua është projekt për të fituar qytetari.

Sokol Haziri – unë shpresoj që tash e tutje do të vazhdojmë me punë në mënyrë më të relaksuar dhe e përgëzoj disiplinën që po e kërkon kryesuesi, por në tema të caktuara ne duhet të hapim debat për të gjitha çështjet.

Unë po them se këtu janë disa çështje teknike, sepse ne në takimin e kaluar ne si opozitë patëm kërkuar që sot të jetë seancë e veçantë, prandaj nuk e di se është seancë e veçantë apo vazhdim i seancës së kaluar.

Izmi Zeka- kjo është vazhdim i seancës së kaluar.

Sokol Haziri- e dyta rreth çështjes së PPP-së, mua më duket se gjërat janë duke u ngatërruar keq! Së pari shihet nga rendi i punës dhe thotë: “Propozim-vendimi për shpalljen e Partneritetit publiko-privat Lokacioni të “Magjistrallja” dhe kur është një formulim i tillë, unë nënkuptoj çështje të tjera. Do të thotë se cilat janë kushtet me të cilat Komuna hynë në partneritet privat? Cilat janë kushtet dhe rrethanat me cilat subjekti publik hyn me atë privat? Ne tash dëgjuam një zgjidhje urbanistike dhe mendoj se në këtë aspekt krejtësisht jeni gabim dhe duhet ose të formulohet pika e rendit të ditës ose të thuhet ajo që e tha zonja nga Urbanizmi, zgjidhje urbanistike për këtë pjesë? Ne kërkojmë sqarime rreth këtyre çështjeve dhe precizime të kësaj pike.

Unë për atë edhe e mora fjalën dhe shpresoj se do të kthjellet koha dhe do të nxeh dielli dhe do të punojmë më të relaksuar.

Nevzad Rushiti- ne në Komitetin për Pronë kemi debatuar dhe një parcelë nuk ka qenë e definuar si parcelë publike? Këtu nuk u dha sqarimi, sepse Kuvendi duhet ta dijë a është e tëra pronë publike apo jo? Unë jam i informuar se një pjesë (parcelë) është pronë e tjetër kujt, të cilit i dihet emri! Kërkoj që të informohet Kuvendi se është e kryer kjo çështje apo jo?

Përveç asaj në emër timin, por edhe partisë që i përkas ne e kemi mbështet PPP-në gjithmonë, por me kushte pak më reale dhe konkrete. Unë po them në emër timin që dy objektet që i kemi lejuar në bashkëpunim me PPP edhe Kadastri dhe te tjetra nuk i kemi gjërat e definuara saktësisht.

Ne njëherë në Kadastër kemi bërë investime në dyer, dritare, fasadim, kurse tash paguajmë qiranë, sepse zyre për Kadastër nuk kemi. Neve na është thënë se pas gjashtë muajve do të ketë lokale dhe banesa.

Florinë Zymberi – unë mendoj se ky projekt ideor është shumë i qëlluar dhe nuk qëndron ajo se ka vetëm beton dhe nuk ka vija gjelbëruese. Nga ajo që unë e shoh dhe e kam analizuar, këtu përveç që ka objekte afariste banesore, është edhe një kopsht i fëmijëve, mandej është podrumi në të cilin gjenden edhe garazhet.

Projekti është i analizuar mirë, sepse mbi garazhe e tërë sipërfaqja është zonë gjelbëruese. Unë mendoj se ky është një projekt shumë joshës, sepse deri më tani nuk kemi pasur projekte të tilla të realizuara.

Sa i përket PPP-së është një mundësi e mirë për zhvillim ekonomik, hap vende të punës dhe i zvogëlon ndërtimet pa leje, ruan tokën bujqësore dhe mënjanohet ndërtimi në mënyrë të pa kontrolluar.

Unë iu ftoj që ta përkrahni këtë projekt!

Riad Rashti-unë shkurtimisht do të sqaroj se ku është interesi i këtij projekti, sepse u tha se nuk ka interes qytetari. Unë mendoj se interesi i qytetarit është i drejtpërdrejtë në këtë projekt, sikurse ka qenë edhe në projekte të kaluara. Unë çuditërisht disa këshilltarë nuk ndalen për t’i analizuar gjërat e të cilët u shprehen shumë keq, sepse dihet se investimet që po ndodhin te Kadastri dhe Kombinati i Duhanit dhe dihet se Komuna së paku do t’i përfitojë së paku 1.5 milion euro për këtë vit. Nëse këto mjete investohen për qytetarët, unë nuk e di se çfarë interesi kërkojnë disa nga këshilltarët?

Interesi është shumë i qartë, ideja dhe procedurat janë shumë të qarta dhe janë ligjore. Është mirë që të mos krijojmë hezitime, por ta mbështesim këtë projekt.

Ramiz Ramadani- unë fillimisht po e pyes drejtoreshën për atë se këtu është një sipërfaqe prej 5384 m² ose mbi 53 ari në të cilin lokacion shihen 4 parcela të cilat shihet se janë pronë komunale. Totali i këtyre parcelave është 4922m² e që në fakt janë më pak për 412 m², prandaj më intereson se nga janë marrë ato 412 m²?

Sa i përket PPP-së, ju e dini qëndrimin e LDK-së, sepse ne vazhdimisht kemi kërkuar sqarim nga njësia për PPP, prandaj edhe në këtë rast po kërkojmë sqarime të destinacionit të ndërtimit. Me të gjitha kundërshtimet që ne po i bëjmë vazhdimisht mendoj se Zyra Ligjore duhet të del me shpjegime se si i definon këto vërejtjet tona.

Vërejtja jonë kryesore është destinacioni i ndërtimit me të cilën kërkesë i bashkohemi z. Sabedit dhe kërkojmë nga PPP që të na japin sqarime edhe atë me shkrim.

Bahrie Mahmuti- sa i përket gishtave të gjelbërimit po e them me shumë përgjegjësi të cilin e elaborova edhe më parë, përsëri po e them se pjesa e Bllokut “A” i cili ndodhet në kuadër të Planit rregullues “Kodra e Thatë”, definimi është i prerë. Në definim këtu kur është aprovuar ky plan është kryesisht afarizëm banesor me objekte përcjellëse. Ajo që është e domosdoshme është ajo që ne e kemi paraparë çerdhe dhe kopshte për fëmijë. Gjelbërimet janë paraparë dhe janë të parapara dhe fushat sportive. Sa i përket sipërfaqes që e përmendi z. Ramizi, unë e kam thënë se është një lokacion i gjer i cili i përfshin edhe zonat ekzistuese? Terrenet sportive do t’i shërbejnë këtyre zonave. Koeficienti i cili është kalkuluar për sipërfaqen ndërtuese nuk është për 53 ari, por për këtë sipërfaqen tjetër e cila i takon këtyre zonave.

Qemajl Mustafa- unë së pari iu falënderoj për aktivitetin e mirë që po e bën Kuvendi rreth kësaj pike. Po theksoj se demokracia jep mundësi të pakufizuar, por së pari duhet të sqarohemi për lokacionin. Këtu është fjala për miratim të zhvillimeve në një lokacion të caktuar dhe shqyrtimi i vendimit për të hyrë në proces.

Duhet ta kuptojmë se në këtë rast nuk po marrim vendim për lidhje të një partneriteti. Ju e dini nga përvoja e atyre dy të parave se është një proces i gjatë dhe tash po e miratojmë vetëm hyrjen në proces për këto dy llamella të cilat janë pronë e pakontestuar komunale. Ky proces zgjatë më së mirë kur shkon puna edhe së paku 90 ditë dhe në ndërkohë në Kuvend do të vijë edhe gdhendja e idesë, pasi të bëhet filtrimi i ofertave dhe nëse investitorët kanë idenë që mos të qëndrojnë fiks në këtë projekt, por kanë dëshirë të lëvizin majtas ose djathtas, prapë kthehen ato propozime arkitektonike si projeksion këtu dhe drafti i marrëveshjes për lidhje të atij partneriteti.

Ne po hyjmë në proces dhe ky proces dëshiron që t’i qëndrojmë pranë, duhet të negociohet, filtrohen ofertat, shikuar kushtet ligjore, pastaj duhet të vijë para Kuvendit për ta votuar kontratën. Ky projekt është bërë shumë i qëndrueshëm dhe këtë e them me bindje të plotë dhe nëse është ruajtur ndonjëherë prona publike dhe interesi publik është ruajtur viteve të fundit.

Ramiz Ramdani- unë edhe njëherë po kthehem te pyetja, sepse ndoshta nuk kam qenë shumë i qartë, sepse po flitet për një lokacion prej 53 ari. Mendoj që drejtorja ka për obligim që të përgjigjet për çdo cm tokë. Nuk na lejohet neve si kuvendarë këto 400m² mos të trajtohen. A është fjala për 5384m², apo për 4922m²?

Nëse më lejohet u përmend disa herë moçalishtja që është krijuar, nuk po e kuptoj pse z. kryetar nuk keni ndërhyrë? Ju keni hyrë 4-5 herë të atë rrubullkasimin, kemi ndërhyrë në plan rregullativ

kundërligjshëm i cili ka pasur implikim financiar, vetëm për ta rregulluar një terren. Pse nuk keni ndërhyrë këtu? Kudo që ka nevojë duhet të ndërhyti!

Arben Mehmeti- sa i përket këtij projekti në emër të grupit të LDK-së dhe personalisht mendoj se nuk është një projekt në interes të qytetarëve të Gjilanit. Këtë po e them se ne e kemi filluar një projekt të tillë me dy ndërtesat e kaluara e për të cilat ne si LDK nuk kemi votuar edhe pse në fillim kemi qenë për hyrje në marrëveshje me PPP, por me kush që të respektohet ligji në tërësi. Në këto raste nuk është respektuar ligji dhe neve na duhet një vendim ose rekomandim i ministrisë përkatëse që merret me këto projekte dhe që ka qenë obligative që ta kemi ne si Kuvend.

Sa i përket kësaj pjese për të cilën po flasim, mendojmë se interesi fund e krye mund të jetë i zyrtarëve të caktuar, mund të jetë edhe i bizneseve të caktuara e të cilat po operojnë në Gjilan, por që po operojnë edhe në dy ndërtesa dhe që në ato objekte kemi edhe zyrtarë të PDK-së të cilët janë të angazhuar me punë në ato objekte.

Unë i shfaq këto dilema dhe kjo jep për të kuptuar se ka nevojë që të rikthehemi tek ato dy objekte për ta parë se çka po bëhet, kush po punon aty, në çfarë forme po punohet?

A janë duke u zbatuar rregullat ligjore në fuqi? Mirëpo dikush edhe duhet të jap e dhe përgjegjësi se në çfarë forme është duke u punuar?

Nga kjo që po shihet është një nguti e tepruar dhe nuk ka nevojë të na thuhet neve se Komuna këtë vit i fiton 1.5 milion euro për shkak të këtyre objekteve, sepse aty janë dhënë në shfrytëzim 50 ari tokë për interesa të ndryshme, kurse prona është në qendër të qytetit dhe e ka vlerën shumë më të madhe se 1.5 milion euro në vit.

Ne në këtë mënyrë si po veprojmë po e luajmë rolin e Agjensionit të Mirëbesimit i cili është quajtur e që në të vërtetë ka qenë “Agjension i Keqbesimit” në Kosovë.

Si duket Komunës së Gjilanit i ka pëlqyer puna e këtij agjensionit dhe po vazhdon me këtë lloj qeverisje me pronat publike.

Si mund të thotë kryetari i Komunës se jam duke e ruajtur pronën publike, kur si të dalim prej kësaj sale kemi të thurura prona publike, afër Teatrit kemi pronë publike e cila është duke u keqmenaxhuar në kundërshtim me çdo rregull. Mirëpo kemi edhe shumë e shumë uzurpime e që nuk është vepruar asgjë për ta luftuar këtë dukuri negative. Ne në fund si LDK kërkojmë që ky projekt të rikthehet prapa dhe të analizohet mirë nga institucionet që e kanë për obligim për të dhënë shpjegime zyrtare ligjore. Nëse na epet një sqarim ligjor nga Zyra Ligjore e Komunës dhe të ministrive përkatëse, ne absolutisht nuk jemi kundër hyrjes në këto partneritete, por në këtë formë si kemi hyrë tash nuk është në interes të qytetarëve të Gjilanit, por është në interes të zyrtarëve të caktuar të Komunës së Gjilanit.

Arben Maliqi- edhe unë po flas në emër timin dhe të grupit dhe e kam thënë se edhe unë jam për partneritet privat, sepse kjo është nevojë e kohës. Jam për një përparim të qytetit dhe pa këtë partneritet, Komuna nuk mund të shkojë përpara. Me këtë rast kemi vende të reja të punës, por edhe unë jam për atë që të jetë në pajtim me ligjin.

Sa i përket këtyre dy ndërtimeve që do të bëhen nuk jemi kundër, mirëpo gjithmonë duhet ta kemi parasysh sa është hapësira e mjaftueshme? U përmenden gjelbërimi, garazhet, mandej çerdhet e fëmijëve, por më duket se 400m² është hapësirë e pamjaftueshme, mandej aty qytetarët e pandërgjegjshëm mund të hedhin edhe mbeturina nga lartë dhe mund të jetë rrezik për fëmijë.

Unë tash po habitem pse tash po flasim ndryshe? Ndoshta është koha e fushatës, por unë mendoj se është herët ende, kjo është në të mirën e qytetarëve tanë, prandaj t’i japim mendimet tona, mos të ngutemi, por as të mos vonohemi. Për këto gjëra duhet ta thonë fjalën jo vetëm ne, por ekspertët të cilët janë më profesional dhe të japin mendimin se a duhet të bëhen këto ndërtime? Duhet të kemi

kujdes se Gjilani është vend sizmologjik, por ne edhe nëpër shkolla nuk i kemi shkallët emergjente. Shumë gjëra duhet t' i kemi parasysh.

Arben Mehmeti- unë po shtoj edhe një që nuk e ka parë kryetari i Komunës. Pikërisht dje kam qenë në “Dardani” dhe lokali i shefit të grupit parlamentar të AKRS-së, Arben Malqi e ka zënë trotuarin. Për këtë arsye unë nuk pres veprime të tjera të këtyre zyrtarëve të cilët janë përfshirë në keqpërdorim të pronave publike.

Këta do të votojnë këtë, sepse nëse votojnë kundër kanë pasoja në këtë drejtim!

Arben Maliqi- sa pari dua ta njoftoj zotëri Arben Mehmetin, se ai lokal nuk është i Arben Maliqit dhe nuk ka të drejtë fare, në tërësi është gabim i tij dhe i keqinformuar.

E dyta aty nuk ka uzurpim, aty është vija e caktuar dhe aty ke mundësi për ta parë vijën e bardhë.

Shukrie Rapuca- për këtë u fol shumë nga anëtarët e Kuvendit, por u dhanë edhe shumë sqarime, por edhe po e them se unë nuk jam eksperte e kësaj lëmie, mirëpo po shtoj diçka nga lëmia të cilën e njoh më mirë. Ndërtimet e larta siç është rasti për të cilin po bisedojmë sot, unë mendoj se ndikojnë shumë në interesin e qytetarëve.

Qytetarët tanë e dinë se është interes i tyre ruajtja e tokave bujqësore. Këto ndërtime të larta janë ato të cilat më së shumti kanë ndikim në ruajtjen tokës bujqësore, sepse mund të paramendojmë sikur të gjithë këta banorë të ndërtonin shtëpi, sa hapësirë do të zihej dhe sa hapësirë gjelbëruese do të kenë ata?

Vjollcë Matoshi- unë së pari në këtë projekt shprehi shumë keqardhje si edukatore për mos përfshirje më të gjerë në këtë projekt të çerdhes e cila do të ndërtohet. Me këtë sipërfaqe prej mbi 479 m², kërkoj një sqarim më detal si: sa do të jetë objekti?, Sa do të ketë gjelbërim?, Nga cila anë do të jetë hyrja dhe të gjitha detalet e tjera?

Qyteti ka nevojë shumë për çerdhe dhe duhet pasur parasysh se aty do të jenë fëmijët tanë dhe duhet kësaj çështje t' i kushtoni më shumë rëndësi. Duhet krijuar kushte për një hapësirë më të madhe çerdhes.

Ejup Haziri-u fol mjaft për këtë projekt, por qëndrimi i PDK-së është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës.

Bahrie Mahmuti- vetëm një sqarim për Ramiz Ramdanin, sepse ai e konteston sipërfaqen, por unë e di se edhe në Komitetin për Planifikim kam dhënë sqarime.

Projekti është i kalkuluar si kompleks i kësaj zone, kurse në vazhdim drejtorja i dha sqarimet sipas kino-projektorit.

Arianit Sllamniku- këtu u fol gjatë dhe shumë tema u prekën, por sidomos ajo për ruajtjen e tokës bujqësore. U përmend edhe punësim, por ky punësim konsiderohet sezonal dhe jo afatgjatë. Mirëpo ajo që mua më shqetëson më tepër është ajo e sigurisë së qytetarëve në këto objekte! Unë në këto projekte nuk kam has në dalje emergjente të objekteve të cilin rast e kam theksuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Gjithashtu edhe dy projektet të cilat janë në ndërtim e sipër nuk e kanë këtë element i cili është me shumë rëndësi për sigurim të qytetarëve në raste të fatkeqësive natyrore. Unë i ngris këto dy gjëra si shqetësim për qytetarët të cilët do të banojnë aty!

Qemajl Mustafa- ne jemi pajtuar me ato vërejtje të Arianitit dhe siguria e qytetarëve duhet të merret parasysh. Te ndërtimet e reja do të ketë mundësi për dalje emergjente, kurse te këto dy ndërtesat ato janë gjëra standarde.

Ligjin për PPP nuk e kemi sqaruar mirë, atë e kanë shoqëritë e përparuara, ato shoqëri të cilat janë sfiduar gjatë kohës së zhvillimit. Ky ligj sot në botën e përparuar sot funksion dhe përmirësohet çdo ditë, sepse nuk ka asgjë të përkryer.

Është thënë nga ajo Njësia për PPP në Prishtinë se në botë ka mbi 2 mijë lloje të PPP-së dhe funksionojnë 2 mijë tipologji të PPP-së. Te ne çdo gjë po ndodh në harmoni me ligjet ekzistuese të Kosovës. Çdo gjë është sipas ligjit, nuk është mirë për të lëshuar pluhur dhe krijuar mjegull para qytetarëve të Komunës pa arsye.

Arbeni po thotë nuk është në harmoni me ligjin, por së paku duhet ta përmendi një ligj ku nuk jemi në harmoni me te?

Izmi zeka- nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon që të aprovohet pika 2.2; propozimi për përcaktim të lokacionit për hyrje në PPP, kështu duhet të jetë. Kush për aprovim të kësaj pike?

Aprovohet pika 2.2.- Propozimi për përcaktimin e lokacionit për hyrje në Partneritetit publiko-privat:Lokacioni te “Magjistrallja” me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 14 ishin kundër, 1 abstenim,

2.3 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike për ndërtimin objektit të Agjencionit të Inteligjencës së Kosovës në Gjilan

Bahrie Mamuti- Drejtorja e Urbanizmit e ka marrë një kërkesë nga AKI-, por FSK, paraprakisht ia ka ndarë një lokacion në sipërfaqe prej 80 ari të cilën ia ka dhënë në shfrytëzim. Kërkesa ka ardhur në drejtori dhe qysh në fazën e parë ne kemi pasur hezitime, sepse në Planin zhvillimor urban ajo zonë është e planifikuar si zonë universitare. Ne jemi duke punuar në plan rregullues dhe nuk kemi pasur mundësi të japim një përgjigje të shpejtë, por pas një analize që e kemi bërë, ne kemi propozuar që t’i ndahen 30 ari. Kjo të cilën e keni ju në dokument është një sipërfaqe që atakohet me pjesën e zonës private dhe kemi bërë propozim zgjidhjen e rrugës e cila do t’i shërbejë edhe pjesës private dhe funksionimit të këtij shërbimi.

Sqarime shumë detale lidhur me lokacionin drejtorja dhe edhe me anë të kino-projektorit.

Sadudin Berisha- ne në Komitetin e fundit për Politikë dhe Financa në takimin e fundit kemi dhënë vlerësim pozitiv, por të njëjtën gjë e ka thënë edhe grupi i LDK-së në Gjilan.

Mirëpo për të ndërtuar një objekt të administratës për AKI-në për Regjionin e Gjilanit ne në takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne kemi kërkuar sqarime, sepse shpesh po thirrmi në ligj, por e vërteta nuk është ashtu!

Vendimet të cilat po na sillen dhe ky të cilin po e debatojmë, dokumentacioni është i pakompletuar, sepse ne këtu e kemi një propozim- vendim për zgjidhjen urbanistike për ndërtimin e objektit të AKI-së e që figuron në emër të Kuvendit të Komunës që do ta sjell. Ne kemi vetëm një propozim-vendim për zgjidhje të lokacionit i cili epet nga drejtorja dhe një kërkesë e cila iu është drejtuar kryetarit të Komunës nga AKI.

Nuk e kemi këtu nga komitetet përgjegjëse, qoftë të Pronës, qoftë atij për Planifikim Urban për ta diskutuar dhe për ta vlerësuar anën e saj pozitive apo negative e cila është e detyrueshme. Këto komitete patjetër duhet për ta bërë vlerësimin, sepse këto vendime miratohen në Kuvend. Asnjë vendim nuk mund të miratohet në Kuvend për pa i kaluar këto rrugë procedurale. Për këtë arsye e

kam thënë edhe herëve të tjera dhe kësaj radhe asnjë prej atyre propozim-vendimeve nuk i kemi këtu dhe lënda është e pakompletuar. Për këtë arsye ne e mbështesim projektin e mbështesim qëllimin, por lënda duhet të kompletohet, duhet të kalojë nëpër Komitetin për Planifikim Urban, në atë për Pronë dhe pasi të kalojnë në këto komitete të sillen këtu.

Në fund pas kalimit të gjitha këtyre procedurave, grupi i anëtarëve të LDK-së e mbështet projektin dhe vazhdojmë më tej.

Florinë Zymberi- duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky agjension, kjo propozim zgjidhje duhet të përkrahet dhe e njëjta duhet të inkorporohet në Planin rregullues urban. Ky propozim në komitetin tonë ka kaluar, ka ardhur rekomandimi nga Komiteti për Planifikim, por Sadudini nuk e ka parë. Ky propozim nuk ka pasur kundërthënie dhe unanimisht ka kaluar.

Sadudin Berisha- unë komunikoj në Kuvend mbi bazën e materialeve që i posedoj. Mirëpo ndodh edhe më e keqja, sepse kur vijnë rekomandimet me propozim- vendime të komiteteve, ato vijnë të pa protokolluara, të panënshkruara dhe ne bëjmë shaka këtu! Çdo dokument që miratohet në komitete duhet të nënshkruhet, duhet të protokollohet dhe adresohet në vendin e caktuar dhe si të tilla duhet të dorëzohen si lëndë e kompletuar, me propozim-vendimin që duhet të miratohet në Kuvend.

Ju asnjëherë nuk e bëni këtë! Çdo lëndë që mund të vijë, po të bëhet një shikim i atyre dokumenteve ose nuk janë të nënshkruara nga komitetet përgjegjëse ose mungojnë fare vendimet. Është e pajustificueshme të thuhet se unë jam kryesuese e komiteti dhe e kemi miratuar. Unë dhe anëtarët e tjerë të Kuvendit nuk e dinë a është miratuar apo jo, për derisa nuk sillet këtu dokumenti i nënshkruar?

Po e përsëris, grupi i anëtarëve të LDK-së e mbështet projektin me detyrimin që të gjitha procedurat të respektohen dhe sillen në Kuvend.

Sokol Haziri- unë po e ripërsëris qëndrimin e AAK-së të paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe po e them se ne pa rezervë e mbështesim këtë propozim me qëllim që t' i shërbejmë rritjes së kapaciteteve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Nevzad Rushiti- përfaqësues e i Komiteti për Pronë jam unë, por kam edhe disa koleg që janë në Kuvend. Ky propozim, nuk ka kaluar në këtë komitet dhe po e jap një vërejtje, sepse që dy raste (dy prona) po vijnë këtu për pa u shqyrtuar në komitet.

Nëse nuk duhet të vijnë më mirë të tregoni, sepse nuk e dimë atëherë pse të ekzistojë ky komitet?

Izmi Zeka- nëse nuk ka kaluar nëpër komitete, atëherë duhet ta kthejmë prapa!

Arben Malqi- ne edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi pajtuar dhe mendoj se nuk duhet të ndalemi, por duhet ta aprovojmë, sepse kjo është në interesin e qytetarëve tanë dhe në interesin e qytetarëve të Kosovës.

Arben Mehmeti- ne e kemi debatuar edhe në komitet dhe e kemi përmendur çështjen e jo seriozitetit të disa trupave dhe të drejtorive. Kuvendin e Komunës disa po e konsiderojnë si trup teknike për t' i kaluar disa vendime që janë me interes.

Unë këtu nuk kam vërejt se ka ndonjë urgjencë, sepse sikur të ishte ndonjë urgjencë ne do ta kishim ndonjë shkresë përcjellëse të Agjensionit ku do të epeshin sqarime për mos ta humbur ndonjë donacion etj. Po të ishte ashtu edhe ne si LDK do të ishim për këtë vendim dhe do të

ishim për ta kaluar projektin. Në këtë rast nuk është ndonjë urgjencë dhe të mos kalojë nëpër komitete që janë profesionale për mua është joserioze!

Ju e keni edhe një shkresë e cila iu ka drejtuar drejtorit të AKI-së nga një zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit i cili e ka anashkaluar Kuvendin, kurse neve na ka qit para një akti të kryer.

Izmi Zeka- nëse ka ndodh kjo, nuk është rregull, sepse çdo vendim duhet t' i kalojë procedurat dhe duhet të mësohemi si të punojmë.

Bahrie Mahmuti- është bërë propozim-zgjidhja e cila do të procedohet në afat sa më të shkurtër në Komitetin për Planifikim dhe në KK, për miratimin e kësaj zgjidhje urbanistike e cila më vonë do të inkorporohet në Planin rregullues i cili është në proces të hartimit. Kjo ka kaluar edhe në Komitetin për Planifikim dhe atë të Pronës. Nuk e kam të qartë pse nuk është inkorporuar rekomandimi i Komitetit të Pronës në material!

Sokol Haziri-kërkoj shumë falje pse e mora për herë të dytë fjalën, por tash po e argumentojmë ne të pranishmit këtu pse shtrihen për tokë policët e Kosovës. Kjo është tema, asgjë tjetër nuk ka, sepse ne merremi me imtësia kur është çështja e sigurisë së vendit. Me dhjetëra vendime kanë kaluar që nuk e kanë këtë peshë dhe nuk i kanë kaluar komitetet përkatëse.

Unë jam për ta respektuar procedurën, por nganjëherë duhet të jemi pak më tolerant, sepse ne në Kuvend jemi autoriteti që vendos. Nuk është edhe me shumë rëndësi një komitet a ka propozuar apo jo, me përjashtim të atij për Politikë dhe Financa.

Për këtë arsye iu lus që të kthehemi në nivelin e përgjegjësisë që duhet ta kem dhe gjërat t' i kalojmë ashtu si duhet!

Ejup Haaziri- unë mendoj ato vërejte që janë serioze të merren parasysh, por këtë çështje nuk kisha propozuar për ta prolonguar. Grupi i PDK-së është për aprovim, por unë edhe në komitet kemi qenë për aprovim të këtij vendimi, por vërejtjet që u dhanë të merren parasysh dhe mos të ndodhin në të ardhmen.

Sdabedin Kadriu- unë i kam bërë 47 vjet dhe asnjëherë nuk kam qenë i dëgjueshëm dhe kurrë nuk kam qenë urë për të më shkel dikush tjetër. Gjithmonë e kam pasur mendimin, ka pasur mundësi ta kem gabim, por gabimi i një personi nuk ka shumë domethënie, është me rëndësi mos të gabojë shumica.

Izmi Zeka- ju lus kush jeni për aprovim të këtij propozim- vendimi?

Aprovohet pika 2.3 e rendit të punës : Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike për ndërtimin objektit të Agjencionit të Inteligjencës së Kosovës në Gjilan me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan.

2.4 Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës përbrenda Kompleksit të shkollave të mesme,

Bahrie Mahmuti- unë po theksoj se Drejtoria Urbanizmit me kërkesë të DA, iu kemi qas hartimit të propozim zgjidhjes së kompleksit të rrethojave të shkollave. Anëtarët e komisionit kanë qenë nga Zyra e Projekteve dhe DA. Si komision po e them me përgjegjësi se kemi punuar me përkushtim

të madh dhe për një kohë të gjatë janë bërë të gjitha analizat detale dhe është planifikuar që zgjidhja urbanistike të jetë në harmoni me kërkesat dhe qëllimi kryesor ka qenë siguria më e lartë e nxënësve dhe arsimtarëve në këto shkolla. Për ta elaboruar më gjerësisht fjalën do ta ketë zyrtarja e cila ka punuar në këtë projekt znj. Selvie Shefkiu.

Selvie Shefkiu – znj. Shefkiu këtë projekt me anë të kino-projektorit para anëtarëve të kuvendit e elaboroi gjerësisht të cilin projekt, anëtarët e Kuvendit e kanë edhe në material të seancës.

Sabedin Kadriu- unë kam qenë punëtor i arsimit dhe gjatë tërë kohës më ka preokupuar gjendja e shkollave tona, por unë i kam disa pyetje për këtë projekt: së pari po lidhem me këtë trotuar që po shihet, sepse nuk po dallohet a është trotuar apo rrugë? Nëse është trotuar atëherë nuk mund të thuhet se ka qasje për këta banorë afër shkollave. Ne duhet t' i themi rrugë, sepse duhet zgjidhur problemet e këtyre banorëve që aktualisht hyjnë nëpër oborr të shkollës.

E dyta mua më pëlqen ajo hyrja te stadiumi, afër konviktit dhe aty duhet të jetë njëloj porte për nxënës.

Pyetje tjetër te Gjimnazi, ku janë disa hyrje dhe janë problematike që shumë vite, çfarë zgjidhje është bërë për këta banorë? Unë mendoj se atë rrugë duhet ta shfrytëzojnë po ata banorë dhe të cilën e shfrytëzon Shkolla Teknike ose duhet të jetë për profesorët të jetë aty.

Një port tjetër duhet të jetë për Gjimnazin, pikërisht ku është hyrja tash (të cilin rast z. Kadriu e elaboron në kino-projektor.

Stadiumin kisha propozuar për t' i bërë një hyrje tjetër dhe jo edhe për stadium dhe profesorë, por të mendohet një zgjidhje nën ambulancë, sepse ka mundësi.

Stadiumit t' i bëjmë një zgjidhje poshtë dhe mos të ketë hyrje fare lartë. Thjeshtë të jetë një hyrje për stadium, kurse tjetër për shkollë.

Ideja është shumë e qëlluar nëse bëhet edhe rrethoja, nëse nuk bëhet rrethoja nuk kemi bërë asgjë!

Sami Hoxha- unë mendoj se ky është një projekt shumë i mirë për të cilin projekt ka pasur iniciativa edhe më herët, por në një mënyrë për disa arsyeje nuk kemi pasur mundësi për ta realizuar. Mirëpo tash po shihet se është një angazhim më serioz dhe më bindës për ta realizuar. Unë e kam një sugjerim timin, sepse çdo dilemë që e kemi duhet t' i bisedojmë këtu dhe ky projekt të dalin sa më i mirë, sepse është në interesin e fëmijëve dhe nxënësve tanë. Te Shkolla Teknike më duket se gjërat janë pak të komplikuar, sepse aty po duhet të sillemi prej hyrjes kryesore, nëpër oborrin e Gjimnazit, mandej të kalojmë në oborrin e Shkollës Teknike. Unë mendoj se ka mundësi që aty të bëhet një lidhje direkt edhe pse e kuptoj atë rëndësinë që i tërë kompleks t' i ketë dy hyrje dhe mos të ketë hyrje të shumta. Mirëpo është mirë të analizohet, sepse ndoshta është më mirë Shkolla Teknike të ketë edhe një hyrje, sepse është shumë më funksionale se sa që po e shoh si është ideja në këtë projekt.

Sa i përket pjesëve të tjera dhe stadiumi i qytetit, është jashtë rrethojës së këtij kompleksi.

Në fund uroj që të gjendet dhuruesi dhe ta realizojmë këtë projekt!

Florinë Zymberi-këtu e keni propozimin e zgjidhjes ideore të këtij projekti të propozuar nga Drejtoria e Urbanizmit. Këtë projekt zonja Shefku e elaboroi shumë gjatë dhe mirë, por i cili projekt ndoshta edhe nuk është edhe ideal, por mendoj se ideja është shumë e qëlluar, sepse bëhet fjalë për

një kompleks shkollor (të shkollave të mesme). Zgjidha urbanistike ofron mundësi që në këtë kompleks të investohet dhe të krijohet kushte më të mira ashtu si meritojnë këto institucione. Nga ky projekt e kuptojmë se këtu kemi të bëjmë me ngritjen e objekteve edukativo-arsimore, rrethojnë e këtij kompleksi, rregullimin e brendshëm (shëtitoret), terrenet sportive, mini restorantet dhe hapjen e dy portave me mundësi kontrolli për të gjithë ata që hyjnë dhe dalin në këtë kompleks. Si kryesuese dhe profesioniste kërkoj që këtë propozim- projekt ta votoni unanimisht, duke pasur parasysh se është fjala për një vend ku prodhohet dituria.

Shkelqim Latifi- unë po e theksoj se edhe Komiteti i Arsimit i ka rekomanduar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për ta mbështetur këtë projekt. Unë mendoj se është një zgjidhje shumë e mirë dhe e qëlluar, prandaj urojmë që të vijjnë investitorët dhe të realizohet në tërësi si projekt. Ne mendojmë se me këtë projekt do të evitohen edhe dukuritë negative të cilat nuk kanë qenë edhe të pakta, kurse me këtë projekt po e krijojmë një ambient të sigurt për mbajtjen e procesit edukativo-arsimor. Po ashtu edhe Komuna do të fitojë nga ky projekt, sepse do të realizohet në bashkëpunim me PPP-në. Me këtë projekt do të fiton edhe Komuna e Gjilanit, por përfituesit më të mëdhenj do të jenë vetë nxënësit.

Tahir Arifi- unë e mora fjalën vetëm për t' i përforcuar dy-tri momente të cilat i theksoi Samiu dhe Sabedini, sepse çështja e qarkullimit të nxënësve të Shkollës teknike bëhet problematike definitivisht me ato hyrje, për faktin se para Gjimnazit, pjesa e hyrjes së arsimtarëve parashihet që të ndahet me një zonë të gjelbër, kurse aty është një kontest gjyqësor të cilin e kanë fituar disa shtëpi të cilat janë afër dhe të cilat kalojnë me makina në atë rrugë. Prandaj me sa di unë nuk lejohet qarkullimi i makinave brenda kompleksit dhe kjo çështje na del problematike. E dyta çështje është fakti se nxënësit e Teknikës kalojnë afër Gjimnazit për të shkuar te Shkolla Teknike dhe ne që jemi atje mund të kemi probleme në të ardhmen. Problemi tjetër është mbyllja e rrugës për qytetarët e "Dardanisë" të cilët janë mësuar që të kalojnë nëpër atë rrugë dhe nuk e di se çfarë do të jetë reagimi i tyre?

Rashtit Sahiti- unë e përkrahi edhe diskutimin e Sabedinit i cili mjaft mirë e sqaroi këtë projekt, por edhe Samiu e tha një të vërtetë të madhe. Unë jam për hapjen e më shumë portave e jo vetëm për dy. E dyta për kontestet pronësore të cilat i përmendi edhe Tahiri, ajo është e vërtetë dhe e pyes zyrtaren: a e din që rruga që kalon nëpër oborrin e Shkollës Teknike që e lidhet me stadiumin, nuk është pronë e Shkollës Teknike, prandaj edhe ajo duhet të jetë rrugë. Mandej unë e di që servituti iu garanton këtyre shtëpive të kalojnë aty. Me servitut kanë të drejtë kalimi. Ajo rrugë nuk duhet të hyjë në rrethojë, por ajo duhet të jetë për ata banorë.

Bahrie Veseli- ne e kemi përkrahur edhe në Komitetin e Arsimit, sepse është një projekt mjaft i qëlluar, mirëpo unë po pyes vetëm se a është bërë zgjidhja e kontestit në oborrin e Gjimnazit? E dyta kam propozim që të ketë porta për hyrje dhe dalje më shumë për nxënësit për të pasur qarkullim më të lirë. Sa i përket restorantit e kam një pyetje se nëse bëhet ai restorant a do të bëhet nën menaxhim të Komunës, pasi që edhe shkollat janë nën menaxhim të Komunës, prandaj çdo gjë aty duhet të mbetet shtetërore.

Sadudin Berisha-kujtoj se për ta lehtësuar punën e Kuvendit, por edhe për ta lehtësuar edhe punën e vet kryesuesi për çdo pikë duhet t'ia jep fjalën përfaqësuesve të grupeve të anëtarëve të Kuvendit, të marrë mendimin e tyre dhe pastaj të hapet debati.

Kështu është rregull për ta ditur mendimin grupeve, mandej debati hapet për së mbari. Sa i përket pikës në fjalë ne ia kemi dhënë mbështetjen e plotë si nevojë emergjente për krijimin e një hapësire më të sigurt dhe më ambientale në hapësirat shkollore. Kujtojmë se ky projekt do të duhej të realizohet sa më parë që është e mundur.

Mirëpo po i përsëris lëshimet që bëhen dhe ne i kemi marrë vlerësimet nga dy komitetet, Komitetit për Arsimit dhe ai për Planifikim Urban, të cilët kanë dhënë vlerësim pozitiv, por sërish po përsëris këtu i kemi dy dokumente të cilat janë krejtësisht jolegale, të paprotokuara, të panënshkruara dhe de jure janë inekzistente.

Përfundimisht duhet të procedohen pikat e rendit të punës ashti si duhet.

Herëve të tjera nëse nuk kompletohet dokumentacioni ne nuk do të marrim pjesë në vlerësim të atyre pikave të rendit të punës.

Ejup Haziri- qëndrimi zyrtar i grupit të PDK-së është për aprovim të këtij projekti, mirëpo ajo nuk do të thotë që të mbetet projekti ashtu si është. Edhe unë që 13 vjet punoj në Gjimnaz dhe dy pika që ndikojnë në mbarëvajtjen e mësimin në Gjimnaz është rruga që po hapet aty për të Shkollë Teknike dhe dy, hyrja për stadium.

Që 13 vjet çdo ndeshje e madhe që bëhet, qoftë ndonjë derbi qoftë diçka tjetër, shkollat zbrazen dhe është e pamundur për t'i kontrolluar nxënësit. Mirëpo nëse mbyllet ajo hyrje dhe aty dhe nuk hapen hyrje më tepër, sepse dy hyrje mjaftojnë për ta mbajtur nën kontroll kompleksin e shkollave. Sa më shumë hyrje është më problematike për t'ia mbajtur nxënësit nën kontroll.

Unë përsëri e kam vërejtjen tek Gjimnazi lartë të hyrja, para shkollës të gjendet një alternativ ose t'ia lejohet edhe Teknikës hyrja vetëm poshtë ku e kanë dhe atje lartë të mos ndërhyhet ose të shikohet edhe një mundësi tjetër të sheshi para kafiterive, aty të lidhen këta banorë dhe aty të hapet rruga. Këtë po e them sepse secili prej banorëve e ka mbyll nga një lokal, garazh që e ka pasur dhe e kanë bërë nga një kafiteri, kurse shkollat të lihen rehat për ta kryer punën e tyre.

Leonorë Bunjkau- ngritja së cilësisë në arsim edhe siguria e nxënësve dhe personelit arsimor janë me shumë të rëndësi për të ardhmen e fëmijëve tanë. Mirëpo për mbarëvajtje të këtyre proceseve, rol të rëndësishëm luan edhe infrastruktura apo rregullimi i një ambienti deri diku me standarde evropiane. Projektin në fjalë ne e kemi përkrah edhe në Komitetin e Urbanizmit, por i njëjti shqetësim të cilin e shfaqen disa anëtarë të Kuvendit edhe mua më ka brengos, do të thotë kalimi përmes një rruge të përbashkët të personelit të Gjimnazit me nxënësit e Shkollës Teknike. Gjithashtu është edhe shqetësimi për banorët të cilët kanë qaseje dhe kalojnë përmes oborrit të Gjimnazit. Ne duhet të bëjmë ndonjë marrëveshje, të vijmë deri tek ndonjë kompromis dhe njëherë e përgjithmonë të zgjidhet ky problem.

Arben Maliqi- një ndër vendimet më të rëndësishme gjatë këtyre katër vjetëve pa dyshim që është edhe kjo pikë e rendit të ditës. Unë mendoj se kjo është një kërkesë imediate, është çështje me shumë rëndësi, sepse kemi të bëjmë direkt me fëmijët tanë dhe ardhmërinë tonë. Unë kam disa pyetje për drejtorin Bahrie, por dhe do ta shfaq edhe mendimin tim, gjithashtu do ta jep edhe

ndonjë sugjerim. Së pari mendoj se në komision ka qenë desh të jetë edhe një ekspertë i edukatës fizike, sepse kemi të bëjmë me shumë fusha të sportit.

E dyta që është me shumë rëndësi që me këtë rrethojë bëhet ngritja e cilësisë në mësim, ngritja e sigurisë dhe bëhet një kontroll më adekuat i procesit edukativo-arsimor.

Unë i dëgjova disa shifra të cilat nuk përputhen me materialin që këtu e kemi. Ne i kemi këtu 7500 nxënës të cilët gravitojnë, kurse aty është diçka tjetër, mandej aty janë 4 hektar e 902 ari ju thatë që ka më shumë, por kjo nuk ka shumë rëndësi?

Mirëpo mua më pëlqej që stadiumi i qytetit, ai stadium në të ardhmen do t' i mbetet kompleksit të shkollave të mesme. Ne mendojmë që ashtu duhet të jetë dhe është ide shumë e qëlluar. Mirëpo aty është mirë që ekspertët duhet të mendojnë mirë se a është e mirë ajo zgjidhje apo ajo? Në anën tjetër u tha këtu që të bëhen edhe dy-tri hyrje, por unë pajtohem se nuk do të mund ta mbajmë kontrollin nëse bëjmë shumë hyrje, mirëpo në anën tjetër është problem që nxënësit e Shkollës Teknike të kalojnë nëpër hyrje të Gjimnazit. Edhe tjetra që është me rëndësi është kontesti me ata banorë, unë mendoj se me ata banorë do të kemi probleme, prandaj është mirë që mos t' i dëmtojmë qytetarët, ta gjejmë një zgjidhje dhe ta kuptojmë drejtë se kjo nuk është zgjidhje personale, por zgjidhje për fëmijët tanë.

Unë në emër timin dhe të grupit tim e përgëzoj kryetarin e Komunës i cili ka mbështetje të plotë prej qytetarëve, sepse po ndodh një ngjarje shumë madhe, po ndodh një gjë e cila është në të mirë të fëmijëve tanë. Edhe njëherë uroj që dhuruesit të jenë vendas, lokal dhe mos të jenë jashtë Komunës së Gjilanit edhe pse me ligj kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës në këtë projekt.

Arianit Sllamniku- mua më intereson një fakt të cilën nën të ndryshme do të diskutojmë. Mua më intereson se këto hapësira a jemi në gjendje për t' i toleruar ose lejuar që të gjithë nxënësit t' i shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë të mundshme?

Sa i përket pronës nuk do të kisha pasur dëshirë ta diskutoj për vet faktin se, anëtarja e grupit Leonora i dha komentet. Mirëpo shqetësimi im është te vajzat të cilat janë larguar pa ndonjë arsyeje e të cilat gjëra do t' debatohet në pikën nën të ndryshme.

Bahrie Veseli- brenda mundësive, por edhe drejtorit i kam bërë kërkesë për një rrugë në Lagjen e Tetë e cila rrugë është tepër e degraduar dhe është vështirë për të kaluar, prandaj të përfshihet në këtë projekt rruga afër kësaj shkollës në këtë lagjeje.

Ky rast është emergjent, prandaj kërkoj nga kryetari që të bëjë një zgjidhje sa më parë.

Bahrie Mahmuti- sa i përket pyetjes për trotuarin rreth rrethojës së shkollës me këtë propozim zgjidhje është trotuar.

Sa i përket numrit të portave është bërë analiza dhe besoj se kjo që është propozuar është zgjidhja më e mirë, sepse siguri i nxënësve dhe personelit mësimor është më në nivel, sepse sa më pak porta siguria do të jetë më e mirë.

Nxënësit e Shkollës "M. Isai" i kanë dy mundësi, varësisht nga cila anë e qytetit vijne në shkollë. Këta i kanë dy alternativa edhe prej portës një edhe prej portës dy.

Në vijim drejtorja me anë të kino-projektorit jep sqarime për këtë rast.

Bujar Nevzadi- pas tërë këtij debati mua nuk më mbetet tjetër vetëm se i falënderoj anëtarët e Kuvendit për përkrahjen që ia dhanë këtij projekti. Ne i kemi shterë të gjitha opsionet për ta kompletuar këtë projekt, kemi pasur debate me qytetarë, me Këshillin e Shkollës, të Prindërve dhe në fund kemi arritur në përfundim për ta realizuar këtë projekt. Unë e falënderoj Drejtorinë e Urbanizmit për punën që e kanë bërë për këtë projekt, por edhe të gjitha komitetet të cilat e kanë mbështet.

Duhet t' i sqaroj se kjo është iniciativa e parë në Kosovë. Në asnjë qytet të Kosovës nuk ka komplekse të shkollave të mesme siç është ky propozim i Komunës së Gjilanit. I falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në këtë projekt dhe dëshiroj që të realizohet sa më parë në mënyrë që të sigurohen fëmijët tanë.

Sami Hoxha- mua po më pëlqen aspekti teorik, por në praktikë te portat dhe ata që merren drejtpërdrejtë në procesin arsimor dhe e dinë gjendjen se si funksionon kjo, do të thotë tek Shkolla Teknike duhet të bëhet një rreth rrotullim për të kaluar te hyrja dhe është një ngarkesë e madhe te Gjimnazi, sepse aty bëhet numër i madh i nxënësve dhe ajo do të jetë jo funksionale në praktikë. Unë mendoj se më funksionale do të jetë nëse sigurohen portat te Shkolla e Teknikës.

Sabedin Kadriu- z. Kadriu i dha disa sqarime lidhur me këtë projekt duke e ilustruar me anë të kino-projektorit.

Qemajl Mustafa- ky projekt është menduar për shkak të kontrollit më të mirë dhe me më pak shpenzime me dy hyrje. Është e vërtetë se aty fluksi rritet kur hyjnë fëmijët dhe dalin prej ndërrimeve është fluks shumë i madh. Unë propozoj që të fillohet dhe të shihet a po funksionon? Të lihet për një periudhë të shkurtër të testimit dhe nëse nuk funksionon, atëherë është propozimi tjetër të cilin e kemi diskutuar me drejtorin dhe zyrtaren, znj. Shefkiu që nxënësit dhe personeli i Shkollës teknike të ketë qasje nga ana e rrugës së dytë, në drejtim që trotuarit i cili është 5 m. Kjo është një rrugë mjaft e gjerë dhe totalisht e liron tërë hapësirën. Unë mendoj se kështu duhet të jetë dhe nëse nuk funksionon, ne menjëherë e hapim edhe një hyrje tjetër e cila nuk e rrit shumë koston.

Këtu u përmend edhe servituti, por ky është vendim i padrejtë i gjykatës, është shkelje e pronës publike, shkelje e pronës së arsimit(zonës shkollore).

Izmi Zeka- nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi propozon që anëtarët e Kuvendit të deklarojnë se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës me këto vërejte që u dhanë nga kryetari i Komunës?

Aprovohet pika 2.4: Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës përbrenda Kompleksit të shkollave të mesme me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

2.5 Studimi i arsyeshmërisë së PPP -Rregullimi i infrastrukturës të Kompleksit të shkollave të mesme të Gjilanit

Jakup Bajrami- sa i përket kësaj pike të rendit të punës, unë në Komitetin për Politikë dhe Financa i kam dhënë sugjerimet e mia, por do ta shprehim edhe këtu mendimin tim në Kuvend, sepse e kam këtë të drejtë. Unë mendoj para së gjithash sa i përket kësaj pike për bashkëpunim me PPP-në,

mendoj se ne po bëjmë përpjekje për ta vu një rend në kompleksin e shkollave të mesme duke bërë rrethoja të objekteve për ta bërë një siguri sa më të mirë për nxënësit. Mirëpo kam bindjen se PPP do t' i ketë katër qendra për freskim të nxënësve (kafiteri), por mendoj se ne me këtë rast do ta krijojmë një kaos, sepse nuk do të mund të kemi kontroll të mjaftueshëm të nxënësve.

Unë e lus kryetarin e Komunës që të gjejë alternativa tjera, duke i shkurtuar disa projekte të tjera dhe duke kërkuar ndihmë edhe nga Ministria e Arsimit për të qenë mbikëqyrja institucionale dhe jo të hyjë aty PPP. Më mirë ato lokale të menaxhohen prej Komunës, se sa të hyjë aty dikush i cili nuk mund ta bëjë kontrollin e nevojshëm.

Sadudin Berisha- vlerësimi i ynë është dhënë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe e kemi parasysh se këtu është një kosto mbi 400 mijë euro për t' u realizuar ky projekt mjaft i rëndësishëm për shkollat e mesme. Mirëpo ky investim duhet të jetë nga buxheti i Komunës, në bashkëpunim me buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse po të futet PPP në objektet ku edukohen dhe arsimohen fëmijët dhe nxënësit tanë, mendoj se është e pa justifikueshme. Hyrja e PPP-së në atë hapësirë nuk mund të justifikohet, prandaj propozimi i ynë është që ky projekt të realizohet nga buxheti i qytetarëve të Kosovës dhe të menaxhohet nga KK, përkatësisht nga Drejtoria për Arsim.

Çdo ndërhyrje e kapitalit privat në këtë kompleks mendoj se do të bëjë ç'rregullime të brendshme. Interesi i atij investitori do të ishte ngritja e katër kuzhinave për 7 mijë nxënës dhe gjysma e tyre po të harxhojnë nga 1 euro gjatë periudhës mësimore e që shkaktohen mjaft telashe dhe nuk mund të justifikohet një investim privat.

Ky investim duhet të jetë publik dhe mbi këtë bazë ne e mbështesim, kurse jo kështu si është propozuar.

Arben Maliqi- unë po e shoh se këtu duhet të ndërtohen 4 fusha të volejbollit, prandaj kërkoj që gjithçka që ndërtohet duhet të mendohet mirë, sepse ka kaluar koha e ndërtimit të fushave të sportit me beton dhe asfalt. Është e mirë ajo që e tha parafolësi që ne vetë t' i ngrisim këto objekte, por pa PPP nuk mund ta realizojmë, sepse kostoja është 800 mijë euro dhe jo 400 mijë.

Në këto investime duhet të kemi kujdes se çka po ndërtojmë dhe si po ndërtojmë? Fushat e sportit duhet të jenë me standarde, tash e tutje funksion Federata e Sportit Shkollor në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Sportit. Nëse nuk janë fushat sipas standardeve nuk mund të bëhen gara dhe betoni dhe asfalti duhet larguar njëherë e përgjithmonë. Këto fusha duhet të ndërtohen me goma ose bari artificial .

Mirëpo aty është e paraparë edhe një fushë e mbuluar në formë tende me një kosto mbi 77 mijë euro, kurse pa mbulojë 51 mijë euro. Unë mendoj dhe këtë e dinë profesionistë se në shek. e 21 nuk lejohen të ndërtohen më fusha të mbuluara, sepse janë me pasoja fatale dhe janë kancerogjene. Fusha të mbuluara më nuk ka askund, me përjashtim në Kosovë, prandaj duhet të mendohet mirë për shëndetin e fëmijëve tanë.

Sabedin Kadriu- e tha drejtori i Arsimit se për herë të parë në Kosovë po hartohet dhe do të realizohet një projekt i mirë. Unë sinqerisht po e them në çfarëdo forme do ta përkrahi edhe në formë të PPP-së edhe pse në pika të tjera kam qenë kundër PPP-së. Në këtë pikë do ta përkrahi edhe PPP-në, sepse kjo është në interes të nxënës të Komunës sonë.

Sami Hoxha- unë mendoj se këtu janë ato dallimet që ishin në fillim të kësaj seance, sepse është një investim që ka një natyrë tjetër, ndërsa këtu te ky kompleks i shkollave, natyra është krejt tjetër. Edhe ky PPP i cili do të funksionojë do ta ketë një mbikëqyrje tjetër, sepse këtu është e lidhur me shkollat. Shkollat nuk mund t' i dorëzohen askujt, ato duhet të jenë dhe janë në menaxhim të Komunës dhe mendoj ato qendra freskuese, kujtoj se mbikëqyrja nga ana institucionit të shtetit duhet të jetë ndryshe nga ato objektet e banimit.

Unë mendoj se aty do të ketë mbikëqyrje të përhershme dhe mendoj se me një angazhim si ka filluar ky projekt do të jetë një projekt i mirë dhe do të vazhdojë mbikëqyrja në mënyrë institucionale. Kjo nuk mund të ndodh ndryshe?

Qemajl Mstafa- ne do të dëshironim që investimi të jetë publik, absolutisht këtu nuk ka dilemë. Mirëpo nëse në ndërkohë në atë fazën e ankandit për ato dy hapësira, nëse mund t' i shndërrojmë në para ato hapësira tona, atëherë është mundësia për ta bërë investimin publik. Dua ta sqaroj se më lehtë do të ishte sikur t' i kishte paratë Komuna dhe ajo të investojë, por madje shërbimet do të jenë private, Komuna nuk do të jetë kafiteri.

Te PPP, kontrata duhet të bëhet kujdesshëm, unë nuk kam asnjë hezitim, unë kam vetëm një problem tek projektimi i mirë i kontratës. Kontrata duhet të bëhet shumë kujdesshëm, këtë edhe ligji e parasheh.

Nuhi Nuhi- edhe mua po më befasojnë disa gjëra, por më tepër ajo si menaxhohen këto fusha? Nëse nxënësit nesër do të dalin në orët e edukatës fizike, a do të paguan qira komuna për ato fusha që do të ndërtohen? Këtë duhet ta mendoni mirë, sepse kur aty hynë paraja private, ai zotëri nuk del lehtë! Për mua është më mirë të zgjatet afati kohor me investime të vet Komunës apo dhurues të ndryshëm se sa me PPP-në. Unë nuk jam që PPP, t' i fus duart edhe nëpër shkolla.

Izmi Zeka- nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës me ato vërejtje që u dhanë?

Lidhur me pikë 2.5: Studimi i arsyeshmërisë së PPP -Rregullimi i infrastrukturës të Kompleksit të shkollave të mesme të Gjilanit, anëtarët e Kuvendit votuan kështu; 16 anëtarë ishin për aprovim, kurse 16 të tjerë ishin kundër, por me votën e dyfishtë të kryesuesit të Kuvendit kjo pikë e rendit të punës u aprovua.

2.6. Shqyrtimi i Draft kontratës për PPP të KRM “Higjiena”

Izmi Zeka- kjo çështje është debatuar gjatë, prandaj propozoj që të deklaroheni se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2.6: Shqyrtimi i Draft kontratës për PPP të KRM “Higjiena, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin kundër dhe 1 abstenim

2.7. Vendimi- për aprovim të Statutit të ndërmarrjes “ECOHIGJIENA”

Izmi Zeka- kryesuesi propozon që të aprovohet pika 2.7;

Aprovohet pika 2.7 e rendit të punës: Vendimi- për aprovim të Statutit të Ndërmarrjes “ECOHIGJIENA:” me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin kundër

2.8 Propozim vendimi për largimin e mbetjeve nga ish Lapidari në fshatin Zhegër

Izmi Zeka- ky propozim ka qenë në komitet, ju lus të deklaroheni se kush është për?

Aprovohet pika 2.8 e rendit të punës: Propozim vendimi për largimin e mbetjeve nga ish Lapidari në fshatin Zhegër me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 1 ishte kundër, kurse të tjerët abstenojnë.

2.9. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P- 70403013-00635-7, me sipërfaqe prej 370 m², ZK-Gjilan

Izmi Zeka- ju e dini dhe e keni vendimin se ky propozim është për ish Komandantin, Shefket Musliun, të cilin propozim e kemi pasur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe e kemi rekomanduar.

Sami Azmi- kjo kërkesë e Komandantit Shefket Musliu ka kaluar nëpër të gjitha procedurat, por ne si grup i AAK-së kemi kërkuar edhe para një viti që t’i mundësohet ky propozim, mandej kemi votuar edhe një projekt i cili ka qenë shumë i qëlluar me të cilin e kemi propozuar një banesë kolektive për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve.

Ne kemi kërkuar qysh moti të gjenden edhe troje për këto familje, sepse një numër prej tyre ende është në gjendje të mjerueshme dhe në mëshirë të kohës. Ne këtë e mbështesim, por kisha propozuar, që të merret parasysh edhe gjendja e ish luftëtarëve dhe invalidëve të tjerë.

Izmi Zeka- ne këtë propozim do ta propozojmë për ndonjë seancë të ardhme në të cilën do ta formojmë një komision nga të gjitha partitë. Do të shikojmë ndonjë pjesë periferike të pronës për t’ia ndarë qoftë familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve.

Arben Mehmeti-unë nuk jam për ta penguar askënd nëse dikush ka merita për këtë vend, por nuk jemi për atë që ky Kuvend t’i shërbejë dikujt për nevoja teknike.

Derisa këtu ne po propozojmë një vendim për t’ia ndërtuar dikujt një shtëpi, ajo shtëpi gati është ndërtuar, kurse ne në këtë rast si Kuvend gjendemi para një akti të kryer.

Në këso raste unë jam kundër këtij pozicioni dhe jam për atë që Kuvendi mos të merret me këtë punë nëse puna është e përfunduar në terren.

Izmi Zeka- edhe unë nuk kam informata të sakta, por nëse ka filluar ai zotëri shtëpi në pronë të Komunës për pa e kaluar procedurën, ky është absurd i veçantë.

Arben Maliqi- mua po më duket e pakuptimtë me atë se me çka merremi nganjëherë me gjëra që nuk ia vlen as të merremi. Ju e dini shumë mirë se çfarë borxhi kemi dhe moti ka qenë desh ta përfundojmë këtë çështje. Të merremi tash me atë është ndërtuar apo jo, kjo nuk ia vlen! Unë jam mos ta banalizojmë këtë propozim, por ta kalojmë sa më parë.

Izmi Zeka- unë jam në pajtim, por nëse ai njeri e ka ndërtuar shtëpinë, ne ende nuk ia kemi dhënë pronën, nuk e ka në shfrytëzim. Për këtë e thash se është absurd i llojit të vet.

Qemajl Mustafa- unë po e them se kjo kërkesë e këtij luftëtari ka qenë 1 vit te ne. Tjetër është pse ligj bërja nëpër mekanizmat tonë institucional po na vonon irlutueshëm.

Personalisht nganjëherë jam i irlutuar me mënyrën se si funksionon ligji. Edhe te ai lokacion i AKI-së një vit është sjell nëpër zyra tona. Rasti i këtij personi dhe zvarritja e këtij rasti për mua është i paarsyeshëm prej Kadastrit dhe Urbanizmit.

Sokol Haziri- unë nuk e kam këtë informatë se ky person e ka filluar shtëpinë dhe e ka përfunduar! Kjo çështje duhet ta ketë një përfundim ose po ose jo! Ka edhe aso disponimi dhe nëse dëshironi, dërgojeni në Maqedoni, ai është mësuar për të jetuar në tenda.

Ai neve na ka respektuar me kërkesën që ia ka bërë institucionit, kurse kur ne e marrim vendimin në vjeshtë apo pranverë është tjetër çështje.

Qemajl Mustafa- këtu është rekomandimi i Komitetit të Pronës dhe Urbanizmit i cila ka kaluar në muajin e dhjetë në këto komitete. Mirëpo ka tentuar në drejtim të ambulancës afër rrugës ta marrë token, unë nuk kam qenë i pajtimit, por kemi propozuar tjetër vend, por këtë ka qenë desh Urbanizmi ta definojë. Unë teshun e kritikës e drejtova në drejtim të prolongimeve dhe zvarritjeve. Ne ka qenë desh ta thërrasim njeriun dhe t' i themi se ti na ke nderuar, por edhe po të nderojmë dhe t' i sqarohet se cila pronë i ndahet?

Izmi Zeka- iu lus që të deklaroheni se kush është për miratim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2.9: Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00635-7, me sipërfaqe prej 370 m², ZK-Gjilan, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenojnë.

2.10. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të pronarëve: Zyrafete Korqa-Xhevat Selimi dhe KK-Gjilan

Bahrie Mahmuti- në këtë rast Drejtoria e Urbanizmit e ka propozuar një propozim-zgjidhje për këmbim të këtyre pronave në aspektin hapësinor. Do të thotë është ardh një kërkesë nga Zyrafete Korça, prona e së cilës preket me pronën publike (rrugë) dhe me këtë prekje të pronës, ajo nuk e ka pasur të drejtën për të pasur mundësi të ndërtimit të objektit për banim. Kjo kërkesë është refuzuar disa herë, por me kërkesën e pronarit të dytë, është parë mundësi e harmonizimit të ritransferimit të kësaj zone dhe kështu që prona e cila ka qenë private, kurse ka qenë e planifikuar si pronë publike, iu ka marrë Zyrfete Korçës, kurse Zyrafete Korça e ka marrë kompensim prej pronarit Xhevat Selmi, kurse Xhevat Selmi iu ka kompensuar sipërfaqja në zonën komunale.

Në këtë rast janë tri palë; pjesa e zonës komunale, nuk iu ka dhënë pronarit të parë, por iu ka dhënë pronarit të dytë. Ne si drejtori e kemi propozuar këtë formë të zgjidhjes dhe kjo formë e kompensimit të kalojë në këtë mënyrë.

Rashit Sahiti- unë së pari desha ta pyes drejtoreshë se a janë marrë vesh palët? Nëse janë marrë vesh palët, kjo çështje zgjidhet me Ujdi gjyqësore dhe nuk ka nevojë të na ngarkoni me këtë procedurë në Kuvend. Ne nuk duhet t' i marrim kompetencat e gjykatave, sepse gjykata shumë shpjet e përfundon këtë procedurë.

Bahrie Mahmuti- kjo patjetër duhet të kalojë në Kuvend, sepse ne po flasim për pronën komunale dhe është obligim i yni që prona komunale mos të kalojë përmes gjykatave.

Arben Mehmeti- unë nuk kam shumë për të thënë, por kësë kërkesë ka shumë prej qytetarëve të kësaj natyre dhe në këtë rast është për të dyshuar shumë dhe në kësë raste duhet të angazhohet Agjensioni Antikorrupsion, por dhe në disa raste të tjera. !

Izmi zeka- ju lutem të deklaroheni se kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2.10 e rendit të punës: Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të pronarëve: Zyrafete Korqa-Xhevat Selimi dhe KK-Gjilan, me 16 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 12 ishin kundër

Qemajl Mustafa - e thash pak më parë se demokracia lejon shumë mundësi, por qasje e Arbenit më së paku çka mund ta them është dekurajuese dhe është fyese për punën kaq të madhe që e bën Drejtoria e Urbanizmit. Kemi të bëjmë me hapjen e mundësive për zhvillim të familjeve tona, të komunitetit, atje ku ka mundësi duke mos e dëmtuar interesin publik.

Kjo qasje i lëndon këta zyrtarë të cilët kanë punuar shumë gjatë në këto punë. Sot Arbeni e ka pasur rastin për ta parë vetëm një pjesë të punës së kësaj drejtorie.

Në prapa vijë është bërë një punë disa mujore, por unë do të them edhe disa vjeçare.

Duhet zgjedhur fjalorin, këta zyrtarë kanë qenë të juajët kur keni qenë në pushtet dhe jeni lavdëruar me ata. Sot janë prapë të juaj, kjo është pjesa civile e punës. Ju lutem të keni konsideratë!

2.11. Propozim vendimi për ndryshimin Rregullores për taksat, ngarkesa dhe gjoba komunale,

Riad Rashti- në këtë rast nuk ka të bëjë me ndryshim të rregullores, por ka të bëjë vetëm me disa plotësime. Këto plotësime kanë të bëjnë me Sallën e Sporteve.

Sabedin Kadriu- unë nuk kam qenë në seancë të Kuvendit, kur është aprovuar kjo rregullore, prandaj e kam një propozim. Është fjala për qiratë e lokaleve në qytet, sepse ka qenë 7 euro është bërë 20 euro për m², por në këtë krizë ekonomike, mendoj se ka qenë një ngritje shumë e lartë dhe i propozoj Kuvendit që ta zvogëloj qiranë, sepse gjendja ekonomike është mjaft e rëndë. Unë propozoj të jetë një rritje 100%, por jo në atë masë.

Unë propozoj që ajo tarifa maksimale 20 euro të jetë 12 euro.

Riad Rashiti- kjo tarifë nuk është bërë në mënyrë paushalle, sepse ne i kemi analizuar mirë gjendjen mirë në treg. Këto janë qira në të cilat qiramarrësit kanë interes dhe kanë leverdi.

Mendoj se çmimi është real.

Sabedin Kadriu-mua më vjen mirë që drejtori është ekonomist dhe e ka vlerësuar që ekonomia e Gjilanit është zhvilluar shumë dhe ka mundësi për të rrit qira 300%.

Të përgëzoj për këtë aftësi tënden!

Izmi Zeka-për të mos formuar komision tjetër, të mbetet ai komision për ta bërë një rishikim dhe në kohën kur komisioni e kryen punën ne do të debatojmë.
Kush është për aprovim të këtij propozimi?

Arben Maliqi- unë jam i mendimit që pikat nën a, b dhe c të rriten nga 50 euro. Arsyeje pse po e them është, sepse me këto rritje mund ta sigurojmë edhe një punëtor, ne dimë se çfarë profiti kanë bankat dhe nuk do të ishte asgjë që të rritet kjo tarifë për 50 euro.

Aprovohet pika 2.11: Propozim vendimi për plotësimin e Rregullores për taksat, ngarkesa gjybara komunale dhe të bëhet edhe një rishikim, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit

2.12. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë,

Bujar Nevzadi- sikur edhe viteve të tjera edhe këtë vit për bursa të studentëve janë paraparë 40 mijë euro. Ne në Komitetin e arsimit e kemi shqyrtuar këtë çështje e kemi rekomanduar, duke qenë të vetëdijshëm se jemi vonuar, por iu ftoj që ta aprovoni këtë propozim.

Sadunin Berisha- për mua kjo nuk mund të justifikohet tash, sepse ky vendim ka qenë desh të merret në fillim të vitit akademik, gjegjësisht në shtatorin e vitit të kaluar, eventualisht në muajin tetor. Kjo vetëm ashtu mund të justifikohet, sepse vendimi në pikën 1 me pikën 5 bie në kundërshtim, sepse ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe me këtë tekst nuk mund të ketë veprim retroaktiv.

Nëse ne ia kemi kufizuar të drejtën e pjesëmarrjes studentëve të vitit të parë për shkak të kriterëve të cilat janë përcaktuar nuk mund të justifikohet nxjerrja e një vendimi për stipendimin e studentëve që kanë nevojë. Ne nuk jemi kundër stipendimit të studentëve, por vendimi që merret duhet të jetë i justifikueshëm.

Ky vendim ka qenë desh të merret në shtator përkatësisht të merret në shtatorin ardhshëm për vitin vijues. Kjo në këtë mënyrë është në kundërshtim me çdo gjë.

Do të thotë vendimi për ndarjen e bursave duhet të merret në fillim të vitit akademik, mandej përcaktohen kriteret ndahen për vitin vijuese akademik. Te merret vendim në fund të prillit për vitin e shkuar akademik, kjo është përmbyllje, por jo në rregull.

Rashit Sahiti- ne si grup parlamentar e përkrahim dhe votojmë për këtë propozim edhe pse me vonesë po bëhen këto gjëra.

Izmi Zeka- kryesuesi propozon që anëtarët e Kuvendit ta aprovojnë këtë propozim-vendim.

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 2.12 e rendit të punës: Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë,

Izmi Zeka- propozoj që të formohet edhe komisioni prej 7 anëtarëve për ndarje të këtyre bursave. Të gjitha partitë ta dërgojnë nga një anëtarë, gjithashtu edhe komuniteti serbë dhe ai turk nga një anëtarë.

Ju lus që të deklaroheni se a jeni për këtë propozim që të jenë 7 anëtarë, nga një prej partive politike dhe dy prej komuniteteve?

Aprovohet ky propozim- vendim me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

2.13. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale të arsimtarëve të cilat kanë kandiduar në zgjedhjet lokale të vitit 2007.

Izmi Zeka- iniciues dhe propozues i kësaj çështje është Elez Muji i cili edhe do ta ketë fjalën.

Elez Muja- lidhur me këtë pikë të rendit të punës, z. Muji theksoi se kjo është një iniciativë e vet arsimtarëve të cilët kanë qenë të propozuar për këshilltarë komunal në garat parazgjedhore të vitit 2007. Ata arsimtarë gjatë kohës parazgjedhore derisa kanë qenë në këto gara, por të cilët e kanë mbajtur edhe mësimin, sepse nuk ka pasur zëvendësim adekuat. Mirëpo këta arsimtarë nuk kanë pasur asnjë informacion se nuk do të kompensohen gjatë tërë kohës derisa zgjat fushata parazgjedhore. Këto ishin arsyt pse një numër i konsiderueshëm i arsimtarëve prej asaj kohe nuk është kompensuar, prandaj unë në emër timin dhe të gjithë këtyre arsimtarëve kërkoj që Kuvendi sot të marrë vendim dhe ta bëjë kompensimin e të gjithë këtyre arsimtarëve.

Izmi Zeka- kërkoj që Zyra Ligjore të na sqarojë se sa kemi të drejtë ne si Kuvend të marrim përgjegjësi të tilla?

Hevzi Matoshi- duke pasur parasysh kërkesën që e bërë anëtari i Kuvendit dhe njoftimin që e kam nga Drejtoria e Arsimit, del se kjo çështje është drejtuar në gjykatë, prandaj është mirë që të pritët deri në vendim të gjykatës.

Rashit Sahiti- unë për nga ana morale, jam për t' i kompensuar këta arsimtarë, por së pari i kam disa pyetje për parashtruesin kërkesës? Para se zotëria në fjalë ta bëjë këtë kërkesë në KK, a e din se kjo lëndë është në gjykatë dhe gjykata ka vendos për këtë çështje? Nëse nuk e dinë unë po i them se nga gjykata, këta arsimtarë kanë marrë përgjigje negative. Mandej z. Muja duhet ta dijë se kjo kërkesë ka qenë desh t' i drejtohet MASHT-ti, MEF-it dhe Shërbimeve Publike.

Ndërsa për punën që e kanë bërë e di që ata arsimtarë nuk janë fajtor, por subjektet e tyre partiake që nuk i kanë njoftuar me kohë se është vepër penale që arsimtari të punojë nëpër institucione shkollore nëse është kandidatë për këshilltar komunal gjatë fushatës parazgjedhore. Për këtë arsyeje konsiderojmë se kërkesa drejtuar këtij Kuvendi është në adresë të gabuar.

Elez Muja- jam i njoftuar se lënda është në gjyq dhe jam në njohuri se Gjykata Komunale dy herë ka vendos në favor të këtyre arsimtarëve. Nuk jam në njohuri se Gjykata e Qarkut e ka refuzuar këtë kërkesë dhe unë e posedoj vendimin se Gjykata Komunale për të dytën herë ka vendos në favor të arsimtarëve.

Unë kam vetëm një pyetje; sikur ata arsimtarë mos të kishin mbajtur mësim çka do të ndodhte në ato shkolla?

Rashit Sahiti- kjo është e rregulluar me ligj dhe ai mësimdhënës që është kandidatë për anëtarë të Kuvendit nuk guxon të mbajë mësim!

Tahir Arifi-kjo nuk është bërë për ta gjetur fajtorin, sepse është e qartë! Punëtorët e arsimit nuk janë punëtorë të partive politike, por janë punëtorë të institucioneve komunale dhe ato institucione kanë pasur përgjegjësi që t' i njoftojnë punëtorët arsimorë se nuk kanë të drejtë për të punuar. Ajo që është shumë e saktë është se ata arsimtarë nuk janë fajtorë pse kanë punuar 40 ditë dhe nuk janë kompensuar për punën e tyre! Po të ketë mundësi për ta gjet një zgjidhje do të ishte mirë, prandaj unë iu lus shumë që të kontribuoni për ta bërë ndonjë zgjidhje në favor të këtyre punëtorëve arsimorë.

Izmi Zeka- do të ishte mirë që ne ta bëjmë një rekomandim nga Kuvendi, kurse ministria do të merret me këtë kërkesë, sepse kjo nuk është përgjegjësi e jonë.

Bujar Nevzadi- në mesin a atyre 100 arsimtarëve jam edhe unë, mirëpo ne e kemi humbur kontestin në gjykatë. Avokati i Komunës e posedon aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në të cilin dëshmohet se e kemi humbur kontestin.

Mandej u tha se nuk është ankesa e drejtuar si duhet, sepse pagat i kompenson Ministria dhe jo Kuvendi.

Izmi zeka- propozoj që të shkojë si rekomandim, ju lutem kush është për këtë propozim.

Aprovohet propozim që kjo kërkesë të shkojë si rekomandim në MASHT dhe MEF

2.14. Autorizim i Komisionit për akte normative për plotësim dhe ndryshim të Rregullores së punës së Kuvendit

Izmi Zeka- kush është që ta autorizojmë, Komisionin për akte normative që të bëjnë ndryshime me plotësime në Rregulloren e punës së Kuvendit?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit që Komisioni për akte normative ta bëjë plotësimin dhe ndryshim e Rregullores së punës së Kuvendit.

3. Të ndryshme

Ramiz Ramadani- unë në emër timin dhe të banorëve të fshatit Llashticë ia kam drejtuar një kërkesë kryetarit të Komunës, drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë, por e kam obligim që këtë kërkesë ta paraqes edhe në Kuvend.

Në ambulancën e Llashticës gjendja është alarmante, sepse rryma është ndërprerë që nga shtatori i vitit 2010 e që për këtë rast ndihem fajtor edhe unë. Personeli mjekësor ka bërë përpjekje për ta bërë një zgjidhje me stufa të druve dhe ta keni parasysh se si është gjendja aty me ato stufa! Për këtë arsye edhe personeli shëndetësor ka heq dorë nga vizita, kurse një teknike e cila gjendet aty nuk ka mundësi për ta ndryshuar gjendjen. E lus kryetarin dhe drejtorin që sa më parë ta përmirësoj gjendjen në atë punkt shëndetësor, sepse i tërë borxhi i rrymës është 7 mijë euro.

Qemajl Mustafa- parimisht jam për ta gjet zgjidhjen, sepse ajo ambulancë duhet të funksionojë, por unë kam informacione që ajo me vite të tërë ajo është shfrytëzuar prej dikujt. A ka qenë ajo OJQ, apo diçka tjetër, por me rëndësi është se janë bërë shpenzime enorme. Mos të mbetet që Komuna e ka shfrytëzuar dhe Komuna nuk dëshiron për ta kompensuar rrymën. Shpenzimi është bërë disa vite më parë nga një OJQ e cila e ka lënë borxhin. Ky rast duhet të jetë objekt i gjykatës dhe pajtohem me Ramizin se këtë situatë duhet ta tejkalojmë.

Xhemajl Salihu- renovimi i ambulancës në Llashticë është në prioritet për këtë vit, sepse ka kaluar në komitet dhe kjo është çështje e zgjidhur. Sa i përket vizitave të mjekëve, asnjëherë në Llashticë nuk ka pasur vizitë të mjekut 5 ditë në javë, kurse i vetmi viti i kaluar ka qenë kur mjeku ka qenë në vizitë 5 ditë në javë. Këtë vit për shkak të shkuarjes së numrit të madh të mjekëve në specializim e kemi pak më vështirë, mirëpo asnjë mjek nuk ka të drejtë të thotë se unë nuk shkoj në Llashticë, sepse ka kushte për punë dhe nuk qëndron ajo që nuk ka kushte për punë.

Vitin e kaluar 5 ditë në javë në Llashticë ka pasur mjek, por këtë vit edhe renovimi shumë shpejtë do të fillojë.

Ramiz Ramadani-mos të mbes borxh, sepse aty kanë qenë tri objekte; biblioteka, ofiqaria dhe një zyre e cila është përdorur nga një SHKA dhe një Organizatë e Rinisë.

Të gjithë këta janë shpenzues tanë dhe nuk ka qenë ilegale asgjë. Tash drejtori e ka zgjidhur problemin e ofiqarisë, sepse ofiqaria ka orë të posaçme. Ne po kërkojmë që edhe për ambulancë të bëhet zgjidhja dhe asgjë nuk po kërkojmë më tepër.

Seanca i përfundoi punimet me këto debate, në ora 14.30 min.

Procesmbajtësi

Kryesuesi i Kuvendit

Sali HASANI

Izmi ZEKA